



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 538, datë 30/12/2021

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM
TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME BULQIZË

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

Në mbledhjen e datës 30.12.2021 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetës Kanalizime Bulqizë sh.a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Konstatohet se:

Shoqëria Ujësjetës Kanalizime ka aplikuar për nivel të ri tarifor pranë ERRU, me shkresën nr. 387 prot, datë 01.09.2021 me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", plotësuar dokumentacionin e nevojshëm nëpërmjet shkresës nr. 579 prot., datë 16.12.2021.

Shoqëria Ujësjetës Kanalizime Bulqizë është licencuar me vendimin e KKRR nr. 91, datë 28.07.2020 "Për licencimin e shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Bulqizë sh.a" për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit të afatit.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Bulqizë është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së tarifave.

Sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Bulqizë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Bulqizë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime;
2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Bulqizë dhe Bashkinë Bulqizë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani